



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE
DREJTORIA E SHËRBIMIT LIGJOR

Nr. 2668/Prot.
15

Tiranë 01/12 /2023

URDHËR

Nr. 185, Datë 01/12 .2023

“PËR MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT PËR
AGJENCINË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE 2022-2025”

Në mbështetje të Vendimit nr. 247 datë 20.03.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2015—2023” dhe miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023 dhe Pasaportës së Indikatorëve, Vendimit nr. 547 datë 09.08.2006 të Këshillit të Ministrave, Statut – Rregullores së Funkcionimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Integritetit për Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore 2022-2025.
2. Personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit do të caktohet Znj. Anila Bajraktari. Personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit ka për detyrë të monitorojë zbatimin e Planit të Integritetit, veçanërisht planin e veprimit për menaxhimin e risikut të integritetit, si dhe të japë sugjerimet e nevojshme për përmirësimin e tij.
3. Personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit, së paku 1 herë në vit, por edhe më shpesh nëse është e nevojshme, është i detyruar të paraqesë para titullarit të institucionit një raport mbi zbatimin e planit të integritetit.
4. Ky urdhër publikohet për njohje në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR EKZEKUTIV
Erlind Sulo